

## Kjo Shqipëri ka rritun burra, që nuk njohin dy flamura

**Sulejman Cakoni**

Historikisht Mali njihet si treve e shquar e mendjes dhe e trimërisë dhe vazhdimisht ka lindur burra që kanë udhëhequr, jo vetëm nacionalizmin, por e kanë treguar veten të zot edhe në kohë e situata të vështira. Fikriut më 27 maj, 61 vjet më parë nga goja e njerit prej këtyre burrave dalin thënie të edhe pse ishte në dhe të huaj, dalin thënie: "Kjo Shqipëri mua më ka rritur, kurë prej meje s'ka me u shtur". I pari dëshmor i rrethit të Matit dhe i dyti në tërë Shqipërinë, ambas Mujo Ulqinaku, është Shahin Toçi, i ri 22-vjeçar më 27 maj 1939 në rrugën "Trans Tevere" nr.45 në Romën fashiste ra i vramë prej fashistëve pse nuk tradhdoi atdheun e tij, nuk u betua për Mbretin e Italisë.

### Kush ishte Shahin Toçi

U lind më 7 nëntor 1917 në një familje të njohur për tradita patriotike e atdhedashurie, në fshatin Urxallë të rrethit Mat. Mësimet e para i mbaroi në fshatin Derjan dhe më pas vazhdoi mësimet në gjimnazin e Tiranës. Në vitin 1933 i mbaroi këto mësimet me rezultate shumë të mira. Gjatë vitit 1933-1934 punoi si hyzmeqar në një familje tiranase, për mungesë akordimi shkollë. Në vitin 1934 iu akordua e drejta e studimit për në Akademinë Ushtarake të Italisë në specialitetin Kavaleri-Financë, të cilën e përfundoi në vitin 1938, ku u titullua oficer i Ushtrisë Kombëtare Shqiptare. Me të mbaruar Akademinë Ushtarake u emërua në dikasterin e ministrisë së Mbrojtjes së asaj kohe po në këtë vit. Pas dy muajsh iu akordua një kurs specializimi pasakademik për shtabet e larta të ushtrisë, të cilin e vazhdoi gjatë vitit 1938-1939, deri sa u vra nga policia sekrete italiane më 27 maj 1939.

### Arsyja dhe rrethanat e vrasjes së tij

Ndonëse ende i ri, por i kompletuar me arsim e kulturë dhe me ideale të larta atdhetare dhe luftëtar i vendosur për çështjen kombëtare shqiptare, pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste e priti me indignatë të thellë dhe vazhdimisht e komentoi atë në rrethin shoqëror të tij si një padrejtësi e madhe që i bëhej popullit dhe kombit shqiptar. Njëkohësisht e kundërshtoi atë dhe

**\* Përkujtojmë me respekt 61-vjetorin e rënies heroike të dëshmorit Shahin Toçi**  
**\* Karakteri burrëror i këtij trimi t'i shërbejë, jo vetëm nacionalizmit, por mbarë shqiptarizmit**

luftoi për të me vendosmëri të madhe. Shprehja e hershme e tij se "Mua Shqipëria më ka rritur dhe kurrë prej meje s'ka me u shtur" midis shokëve të tij shqiptarë e bëri atë të jetë i përbetuar për çështjen e madhe kombëtare shqiptare. Gradualisht nga plani personal kaloi në planin e përgjithshëm, duke marrë dhe atributet e një udhëheqësi për të kundërshtuar pushtimin fashist italian. Qarqet qeveritare italiane, për të përponuar intelektualët shqiptarë që i dëdheshin në Itali dhe për të justifikuar këtë pushtim të Shqipërisë se gjoja ai bëhet në emër të mirësisë së Shqipërisë dhe se atë e kanë pranuar edhe inteligjencia shqiptare brenda e jashtë vendit, organizoi një ceremoni festive për t'u betuar përpara flamurit italian. Gjatë muajit maj (në gjashtëm e parë të tij) të vitit 1939 filluan provat dhe Shahin Toçi që ndër të parët studentë shqiptarë që e kundërshtoi, duke vepruar edhe hapur për sabotimin e këtij betimi. Në ceremoninë provë të datës 13 maj 1939, Shahin Toçi kish hyrë në rresht midis rreth 300 shqiptarëve me uniformën e oficerit shqiptar. Kur e pa këtë uniformë sekretari i shtetit për luftën, gjeneral Alberto Periani iu drejtua djalosht shqiptar Shahin Toçi duke i thënë: "Ç'është kjo uniformë dhe kush të ka urdhëruar ta veshësh? Shahin Toçi aty për aty iu përgjigj: "Ne jemi shqiptarë dhe kjo është uniforma jonë zoti gjeneral".

Të nesërmen përsëri do të bëheshin prova, pasi provat e datës 13 maj deshtuan. Në momentin kur gjenerali Periani lexoi formulën e betimit dhe kur thirri fjalën e fundit Betohuni, Shahin Toçi me iniciativën e tij doli përpara rrethit dhe iu drejtua me nervozizëm gjeneralit: "Zoti gjeneral, ne jemi betuar njëherë dhe vetëm për flamurin shqiptar kuq e zi".

Kjo që një shuplakë e rëndë për qarqet qeveritare italiane të asaj kohe dhe menjëherë djaloshi u vu në shënjestër për ta eliminuar fizikisht. Këtë u ngarkua ta kryente policia sekrete italiane së bashku me agjenturën në radhët e studentëve shqiptarë. Kështu u bë. Më 27 maj 1939 policia sekrete italiane kreu krimin makabër, duke vrarë trimin dhe patriotin e shquar Shahin Toçi në gjumë në natën me pesë plumba, duke e lenë të vdekur në vend. Policia sekrete të parën punë që bëri mori ditat e

Shahinit që kishin shënuar ngjarjet e prillit, të ditëve të zëra për shqiptarët. Si masë tjetër u mor shpërndarja e tërë studentëve shqiptarë në tërë Italinë me qëllim që të mos organizoheshin në demonstrata. Ata nuk lejuan as shokët e Shahinit që të merrnin pjesë në varrimin e tij dhe nuk u bë asnjë ceremoni mortore e fetare.

Në vitin 70 figura e tij vlerësohet nga organet e pushtetit të asaj kohe, duke e shpallur dëshmor i LANÇ-së. Por në vitin 1977 e deri me ardhjen e demokracisë mbi figurën e tij u hodh një hije, deri dhe në mohim të veprës së tij të lartë heroike. Sigurisht që kjo bëhej nga elementë, individë e intrigantë që as familjeve të tyre nuk ju duheshin dhe për këtë jemi dëshmitarë të gjithë se si komunistët janë sjellur me vlerat e njerëzve dhe atributet e shtetasve. E themi këtë për t'i thirrur kujtesës, pasi ertësimi arrii deri aty që të fshinin dhe këngën. Kjo Shqipëri ka lindur burra, që nuk njohin dy flamura. Njëkohësisht të mos harohet se lista e personave që kundërshtuan botërisht betimin ushtarak italian fillonte Shahin Toçi, pastaj Reshit Collaku, Shaban Strazimiri, Asim Zeneli, Elez Braha, Hajrulla Ishmi, Ethem Leti etj. Dokumentet autentike që posedon dosja e tij personale dëshmojnë plotësisht se vrasja e Shahin Toçit është bërë për motive të veçanta si kundërshtar dhe luftëtar kundër pushtimit fashist të Shqipërisë. Për popullin e Matit është një krenari që të tilla figura ia lartësojnë vlerat, jo vetëm familjeve të tyre, por gjithë komunitetit të këtyre trevave. Njëkohësisht opinioni apelon zotërinj udhëheqës e drejtues?

Lartësimi i vlerave është e saktë që i takon brezit që e përjeton. Këtu të shohim nëse kërkojmë e ideojmë që komuniteti të gënjërohet vital, ndryshe do të konsumojmë veten tonë pa patur të drejtë. Po kështu dhe autoritetet lokale e pranojnë dhe apelojnë që eshtrat e Shahin Toçit që prehen në dhe të huaj atje në Itali, në varrezat e Veronës në Romë në sektorin e varreve myslimane numri 16, të riatdhesohet dhe të vendosen në varrezat e dëshmorëve të kombit në Tiranë. Vetëm Mali nuk ka varre në atë varrezë. Mendojmë që së paku për eshtrat e një dëshmori gjendet një vend midis me të nderuarve të kombit.

Z

te

sl

pe

pe

ke

pe

sl

te

ke

e

y

T

pe

ri

n

ti

a

n

ke

u

h

pe

pe

v

y

if

q

n

ni

dl

ar

2

sl

ni

ai

m

sl

pe

Gi

ve

sh

bu

Gr

si

e

p

rrit

s'ka

s'ka

e tra

i tra

e jo

mbu



Shahin Toçi, dëshmor i parë i atdheut për rrethin e Matit

## "Kjo Shqipni ka rritur burra, që nuk njohin dy flamura"

Nga SULEJMAN ÇAKONI

Historikisht Mati njihet si trevë e shquar e mendjes dhe e trimërisë që vazhdimisht ka lindur burra që kanë udhëhequr jo vetëm nacionalizmin, por e kanë treguar veten të sot edhe në kohë e situata të vështira. Pikerisht më 27 maj, 63 vjet më parë nga goja e njërit prej këtyre burrave u shqiptuan fort fjalët edhe pse ishte në dhe të huaj, "kjo shqipni mua më ka rritur, kurrë prej meje s'ka me u shitur". I pari dëshmor i rrethit të Matit dhe i dyti në tërë Shqipërinë, mbas Mujo Ulqinakut është Shahin Toçi, i riu 22 vjeçar më 27 maj 1939 në rrugën "Trans Tavere" nr. 45 në Romë, ra i vrarë prej fashistëve pse nuk tradhëtoi Atdheun, nuk u betua për mbretin e Italisë.

### KUSH ISHTE SHAHIN TOÇI?

U lind me 7 nëntor 1917 në një familje të njohur për tradita patriotike e atdhetashurie, në fshatin Urxallë të rrethit Mat. Mësimet e para i mbaroi në fshatin Derjan dhe më pas vazhdoi mësimet në gjimnazin e Tiranës. Në vitin 1933 i mbaroi këto mësimet me rezultate shumë të mira. Gjatë vitit 1933-1934 punoi si hyzmetqar në një familje tiranase, për mungesë burse. Në vitin 1934 iu akordua e drejta e studimit për në Akademinë Ushtarake të Italisë në specialitetin (Kavaleri-Financë), të cilën e përfundoi në vitin 1938, ku u titullua oficer i Ushtrisë Kombëtare shqiptare. Sapo mbaroi Akademinë Ushtarake u emërua në dikasterin e Ministrisë Mbrojtjes të asaj kohe po në këtë vit. Pas dy muajsh iu akordua një kurs specializimi pas akademik për shtabet e larta të ushtrisë, të cilin e vazhdoi gjatë vitit 1938-1939 deri sa u vra nga policia italiane më 27 maj 1939.

### ARSYET E RRETHANAT E VRASJES SË TIJ

Ndonëse ende i ri, por i kompletuar me arsim e kulturë të larta atdhetare dhe luftëtar i vendosur për çështjen kombëtare shqiptare, pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste e priti me indignatë të thellë dhe vazhdimisht e komentoi atë në rrethin shoqëror të tij si një padrejtësi e madhe që i bëhej popullit dhe kombit shqiptar, njëkohësisht e kundërshtoi atë dhe luftoi për të me vendosmëri të madhe. Shprehja e hershme e tij se, "Mua Shqipëria më ka rritur dhe kurrë prej meje s'ka me u shitur",

Sapo mbaroi Akademinë Ushtarake u emërua në dikasterin e Ministrisë Mbrojtjes. Pas dy muajsh iu akordua një kurs specializimi pas akademik për shtabet e larta të ushtrisë, të cilin e vazhdoi gjatë vitit 1938-1939 deri sa u vra nga fashistët më 27 maj 1939.

midis shokëve të tij shqiptarë e bëri atë të jetë i përbetuar për çështjen e madhe kombëtare. Gradualisht nga plani personal kaloi në planin e përgjithshëm, duke marrë dhetribute të një udhëheqesi për të kundërshtuar pushtetin fashist italian. Qarqet qeveritare italiane, për të përpunuar intelektualët shqiptarë që ndodheshin në Itali dhe për të justifikuar këtë pushtim të Shqipërisë se goja ai bëhet në emër të mirësisë se Shqipërisë dhe se ata e kanë pranuar edhe intelijenca shqiptare brenda e jashtë vendit, organizoi një ceremoni festive për t'u betuar para flamurit italian. Gjatë muajit maj (në gjysmën e parë të tij) të vitit 1939 filluan provat dhe Shahin Toçi ishte ndër të parët studentë shqiptarë që e kundërshtuan, duke vepruar edhe hapur për sabotimin e këtij betimi. Në ceremoninë provë të datës 13 maj 1939, Shahin Toçi kishte hyrë në rresht midis rreth 300 shqiptarëve me uniformën e oficerit shqiptar. Kur e pa këtë uniformë sekretari i shtetit për luftën gjeneral Alberto Periani iu drejtua djaloshit shqiptar, Shahin Toçi, duke i thënë: Ç'është kjo uniformë dhe kush të ka urdhëruar ta veshësh? Shahin Toçi aty për aty iu përgjigj: ne jemi shqiptarë dhe kjo është uniforma jonë zoti gjeneral. Të nesërmen përsëri do të bëheshin prova, pasi provat e datës 13 maj dështuan. Në momentin kur gjeneral Periani lexoi formulën e betimit dhe kur thirri fjalën e fundit betohuni. Shahin Toçi me iniciativën e tij doli përpara rreshtit dhe iu drejtua me nervozizëm gjeneralit: "Zoti gjeneral, neve jemi betuar një herë

dhe vetëm për flamurin shqiptar kuq e zi". Kjo që një shuplakë e rëndë për qarqet qeveritare italiane të asaj kohe dhe menjëherë djaloshi u vu në shenjestër për ta eliminuar fizikisht. Për këtë u ngarkua ta kryente policia sekrete italiane sëbashku me agjenturinë në radhët e studentëve shqiptarë. Kështu u bë. Më 27 maj 1939 policia sekrete italiane kreu krimin makabër, duke vrarë trimin dhe patriotin e shquar Shahin Toçi në gjurmë të natës me pesë plumba, duke e lënë të vdekur në vend. Policia sekrete të parën punë që bëri muar ditaret e Shahinit që kishte shënuar ngjarjet e prillit, të ditëve të zeza për shqiptarët. Si masë tjetër u muar shpërndarja e tërë studentëve shqiptarë në tërë Italinë me qëllim që të mos organizoheshin në demonstrata. Ata nuk lejuan as shokët e Shahinit që të marrin pjesë në varrimin e tij dhe nuk ju bë asnjë ceremoni mortore e fetare. Në vitin 1970 figura e tij vlerësohet nga organet e pushtetit të asaj kohe, duke e shpallur dëshmor të atdheut. Por në vitin 1977 e deri me ardhjen e demokracisë mbi figurën e tij u hodh një hije deri dhe në mohim të veprës së tij të lartë heroike. Sigurisht që kjo bëhej nga elementë të intriguar që as familjeve të tyre nuk ju duheshin, dhe për këtë jemi dëshmitarë të gjithë se si komunistët janë sjellur me vlerat e njerëzve, dhe atributet e shtetasve. E themi këtë për t'i thirrur kujtesës, pasi errësimi arriti deri aty që të fshehin edhe këngën "Kjo shqipni ka lindur burra që nuk njohin dy flamura". Njëkohësisht të mos harrohet se lista e personave që kundërshtuan botërisht betimin ushtarak italian fillon tek Shahin Toçi pastaj Reshit Çollaku, Shaban Strazimiri, Asim Zeneli, Elez Braha, Hajrulla Ishmi, Ethem Leti, etj. Dokumentat autentike që posedon dosja e tij personale arkivore, dëshmon plotësisht se vrasja e Shahin Toçit është bërë për motive të veçanta si kundërshtarë dhe luftëtarë kundër pushtimit fashist të Shqipërisë. Për popullin e Matit është një krenari që të tillë figura ia lartësojnë vlerat jo vetëm familjeve të tyre, por gjithë komunitetit të këtyre trevave. Pikerisht në këtë sens opinioni apelon sëbashku me autoritetet vendore që eshtrat e Shahin Toçit që prehen në dhe të huaj atje në Itali, në varrezat e Veranës në Romë, në sektorin e varreve myslimane numër 16, të riadhesohen. Ato të vendosen në vendin që ju takon, në Varrezat e Dëshmoreve të kombit Tirane.